



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. të datës 27.12.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës flamurtari" me nr. të prokurimit 616-24-13316-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. të datës 27.12.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës flamurtari" me nr. të prokurimit 616-24-13316-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Albi Company" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 27.12.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës flamurtari" me nr. të prokurimit 616-24-13316-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

P.1. -“Ne si OE kerkojme qe kerkesa e kerkuar Nje EKSPERT te certifikuar nga AME per mbrotje nga zjarri se paku 3 vite pervoje pune nga certifikimi te eliminohet si kerkesa pasiqe eshte e pa nevojshme derisa OE konkurrues e posedojne stafin profesional dhe teknike te trajnuar duke ofruar deshmi certifikatat nga nje kompani e licencuar apo E-kosova”.

P.2. -“kerkojme qe te lejohet OE konkurrues te deshmojne qe kan realizuara kontrata me sukses te natyres se ndertimit te larte”.

P.3. -“ kerkojme qe eliminohen kerkesat ne piken 3, 4, 5 per pozicionet nr 9, nr 12 dhe 13 eshte teper injoruese dhe diskriminuese”.

P.4. -“ Një kamion të pajisur me shportë (platformë ngritëse) me minimum 10 metra lartësi të ngritjes së shportës - Ne si OE konsiderojme se eshte e pa nevojshme e pa arsyeshme qe te jete si pajisje me kamion I pajisur me shporte me min 10 lartesi te nfrityes se shportes”.

P.5. -“ Një kamion me vinç, me aftësi mbajtëse (peshim të ngarkesave), në minimum 10 metra lartësi të ngritjes së peshave SI OE konsiderojme se eshe e pa arsyeshme e pa nevojshme qe lartesia e ngritjes te jete min 10 metra lartesi”.

Fillimisht duhet cekur se parashtruesi ka dorëzuar edhe një kërkesë për sqarime ku ka kërkuar që të largohen një numër i caktuar kërkesave të dosjes së tenderit. Lidhur me sqarimet përgjigja e AK ngarkohet përmes eprokurimit. Duke marrë parasysh se disa nga pretendimet ankimore janë të njëjta për sqarime shitesë parashtruesi mund t'i referohet sqarimeve të ngarkuara në eprokurim.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Sa i përket pretendimit nr. 1 eksperti për mbrotje nga zjarri është i domosdoshëm duke marrë parasysh natyrën dhe qëllimin e projektit. Po ashtu edhe pretendimi nr. 2 është i pabazuar pasi që kërkesa e DT buron nga neni 69 i LPP dhe i referohet projekteve të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit. Pretendimi 3 është i pabazuar pasi që dorëzimi i mostrës në rastin konkret është kërkesë jo vetëm e bazuar në LPP dhe RRPP por si e tillë e domosdoshme për aktivitetin e prokurimit. Ndërsa pretendimet 4 dhe 5 të gjitha janë të pabazuara pasi që pajisjet e kërkuara përmes dosjes së tenderit si të tilla janë absolutisht të domosdoshme për realizimin me sukses të projektit në fjalë.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës,

paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 31.12.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.